



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 88/2012
Prishtinë, më 11.12.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejane Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca dhe Faton Bajra – MTI; Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja – INDEP; Isuf Zejna - KDI dhe Visar Rushiti - GAP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 04 dhe 05.12.2012;
3. Shqyrtimi Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 04 dhe 05.12.2012

Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 04 dhe 05.12.2012 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike

Kryetari – Tha se grupi i punës ka mbajtur dy takime me përfaqësuesit e MTI-së dhe të organizatave të shoqërisë civile siç janë: INDEP dhe GAP, që e mbështesin aktivitetin e Komisionit të cilët i kanë dhënë propozimet e tyre, ku disa prej tyre edhe janë inkorporuar në amendamente. Po ashtu, Komisioni ka organizuar edhe dëgjim publik, ku janë ftuar të gjitha palët që kanë të bëjnë me Projektligjin për zonat ekonomike dhe, gjithashtu, kemi pasur edhe ekspertizë të veçantë me ekspertin e angazhuar. Theksoi së grupi i punës i ka hartuar 28 Propozim-amendamente, pastaj në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës i paraqiti Propozim-amendamentet.

Lutfi Zharku – Propozoi në parim që të fshihet në tërësi ajo dispozitë që ka të bëjë në lidhje me “zonat e lira ekonomike”, sepse kemi legjislacionin në fuqi dhe nuk kemi nevojë që edhe këtu ta kemi të trajtuar këtë çështje.

Rexhep Billaca (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) – Tha se është e vërtetë se kjo çështje është e rregulluar me Kodin Doganor, por pasi që ky ligj specifikisht trajton zonat ekonomike, kemi vlerësuar se mund të rregullohen me këtë ligj.

Pas debatit Komisioni nuk e përkrahu propozimin e z. Zharku.

Lutfi Zharku – Propozoi që në **Amendamentin 5** të fshihet teksti “që mund të jetë zonë e lirë e parkut industrial,”.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Zharku.

Kryetari – Propozoi që më **Amendamenti 10** të fshihet vetëm lidhëza “pas” në paragrafin 1 të nenit 6.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Lutfi Zharku – Propozoi që në nenin 13 të shtohet një **Amendamenti i ri 20**, ku fshinë paragrafin 7 të nenit 20, që ka të bëjë me “kontabilitetin”, sepse legjislacioni në fuqi e rregullon këtë çështje.

Këtë propozim e përkrahen edhe deputetët **Myzejene Selmani** dhe **Hashim Deshishku**.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Zharku. Dhe, si pasojë i këtij propozimi, fshihet edhe propozim-amendamenti 21 i grupit të punës.

Lutfi Zharku – Propozoi që në **Amendamentin 20**, i grupit të punës të ndryshohet tërësisht dhe të mbetet sikurse në projektligj, përveç në paragrafin 1, fjala “Ministria” të zëvendësohet me “Qeveria”, sepse lehtësirat për bizneset janë çështje e Qeverisë në përgjithësi, e jo vetëm e një ministrie.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Zharku.

Lutfi Zharku – Propozoi që **Amendamenti 26** i grupit të punës të fshihet, sepse duhet të mbetet të tri asociacionet siç janë përcaktuar në projektligj.

Myzejne Selmani – Po ashtu tha se pse mos të jenë të tri asociacionet e vendit. Ajo ishte e mendimit që të fshihet amendamenti i propozuar.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Zharku.

Hashim Deshishku – Ishte kundër gjobave të larta të propozuara në **Amendamentin 28** të grupit të punës, si për personin juridik, po ashtu edhe për personin përgjegjës. Ai propozoi që ndëshkimi për personin përgjegjës të jetë dhjetëmijë (10.000) euro, ndërsa për personin përgjegjës dymijë (2.000) euro.

Lutfi Zharku – Propozoi që të fshihet edhe nënparagrafi 1.2 i këtij amendamenti.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Deshishku dhe z. Zharku.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohej Raporti me amendamente i grupit të punës me vërejtjet e deputetëve.*
2. *Raporti t’i procedohet komisioneve të përhershme sipas procedurës.*

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit